



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 257 / 8 prot.

Tepelenë, më 02.02.2026

V E N D I M

Nr. 9, datë 29.01.2026

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES NDIHMË FINANCIARE PËR DËMIN E SHKAKTUAR
NGA ZJARRI NË BANESËN E Z. HASAN HOXHA”**

Këshilli Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e datës 29.01.2026 pasi mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tepelenë, për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z.Hasan Hoxha, në lagjen Ferme, Njësia Administrative Tepelenë banesa e të cilit është dëmtuar nga zjarri, nga buxheti i bashkisë dhe i Ministrisë së Mbrojtjes për emergjencat civile për vitin 2026, në zbatim të ligjit nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile “ , neni 29 “komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku e bashkie” Neni 30 ku percaktohen detyrat e bashkive dhe perkatësisht gërma “gj” ku shprehet: “kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre si dhe dëmshperblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura ne territorin e tyre”, neni 41 “E drejta e kompensimit”, VKM Nr.329 date 16.05.2012 “ për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Neni III, pika ë) “ Këshilli bashkisë, pas shqyrtimit të relacionit të Komisionit të Emergjencave në bashki, proces-verbalit të konstatimit të gjëndjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare, në të cilin përmendet dhe masa e ndihmës së dhënë nga ky organ”.

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Tepelenë për mbështetje financiare të shtetasit z.Hasan Hoxha, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratoj dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Tepelenë.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit z.Hasan Hoxha ndihmën emergjente në vlerë 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, vlerën nga fondi i emergjencave civile i miratuar për vitin 2026 (sipas proces-verbalit të demit të shkaktuar)

4. Ndihma financiare për familjen e mësipërme, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së Nr 329 datë 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të perdoret për ti ardhur në ndihmë të familjes së shtetasit z.Hasan Hoxha.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro 12 (dymbëdhjetë)vota
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 02.02.2026

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

ARBEN GUMENTI

